



Java e Gruas

Konferenca dyditore e Javës së Gruas

Java e Gruas (WoW) është një ngjarje vjetore mbarëkombëtare që mbledh në një mjedis ndëretnik, më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe akademia, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të kapaciteteve të grave udhëheqëse dhe mbështetjes së tyre për marrjen e pozicioneve më të mëdha drejtuese. Gjatë nëntë vjetëve të fundit, WoW ka ofruar një platformë për debat mbi politika dhe diskutim intensiv me liderë politikë dhe zyrtarë të zgjedhur. Kjo u mundëson pjesëmarrësve t'i mbajnë përgjegjës përfaqësuesit e tyre dhe në të njëjtën kohë të mbështesin zhvillimin e shkathtësive për gratë në leadership në politikë.



Prishtinë, Kosovë
15-16 mars, 2022

Në mbrojtje të demokracisë: Gjithpërfshirja ka rëndësi

Dita e parë, 15 mars

Vendi: Hotel Emerald

9:15-10:00 Arritja e pjesëmarrësve

10:00 - 10:40 Fjalët Hyrëse

- Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore, NDI Kosovë
- Shkëlqesia e Saj Dr. Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës
- Shkëlqesia e Tij Jeffrey M. Hovenier, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë

10:40 - 12:30 "Momentum i ri për demokracinë e Kosovës: Mundësitë për pjesëmarrje të barabartë gjinore në parti politike"

Pavarësisht shenjave të qarta të progresit, mbetet shumë punë për t'u bërë për sigurimin e pjesëmarrjes së plotë të grave në jetën publike. Gratë në politikë përballen me barriera të shumta, ndërkaq partitë politike shpesh kanë mangësi në procese të qarta të formalizuara për identifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në lista, si dhe nuk kanë prioritet mbështetjen dhe promovimin e grave. Ky panel synon të diskutojë adresimin e sfidave dhe mundësitë e partive politike për të ofruar një mjedis të sigurt dhe inkurajues për gratë dhe burrat në politikë në akte nënligjore, struktura të brendshme dhe kulturë partiake.

- Albin Kurti, Kryetar, Lëvizja Vetëvendosje
- Memli Krasniqi, Kryetar, Partia Demokratike e Kosovës
- Lumir Abdixhiku, Kryetar, Lidhja Demokratike e Kosovës
- Ramush Haradinaj, Kryetar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- Emilija Redzepi, Kryetare, Partia e Re Demokratike

**Moderatore: Ambasadorja Nancy Soderberg,
Drejtoreshë, NDI Kosovë**

12:30 – 13:45 Drekë

**14:00 – 14:20 Në mbrojtje të gjithpërfshirjes së
grave në politikë**

- Jacqueline O’Neill, Ambasadore e Kanadasë për
Gra, Paqe dhe Siguri

**14:20 – 16:00 “Demokracisë i duhet siguria:
Hapsirë digjitale pa dhunë ndaj grave në
politikë”**

Dhuna ndaj grave në politikë në internet është një problem global që minon pjesëmarrjen e drejtë dhe kuptimplotë të grave në jetën publike dhe në proceset politike. Fatkeqësisht, mjedisi medial dhe hapësirat online në Kosovë nuk janë imune ndaj kësaj sfide. Gratë dhe burrat në poste drejtuese janë subjekt i sulmeve verbale për pozicionet e tyre politike, por gratë janë gjithashtu subjekt i gjuhës së njëanshme, fyese dhe seksiste. Ky panel diskutimi do të synojë të trajtojë ndikimin e dhunës ndaj grave në politikë në internet dhe rolin e partive politike dhe mediave në luftimin e këtij fenomeni, me synimin që të ndihmojë në ndërtimin e diskursit publik dhe kulturës politike gjithëpërfshirëse.

- Saranda Bogujevci, Nënkryetare e Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Doarsa Kica Xhelili, Kryetare e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Eliza Hoxha, Deputete dhe Anëtare e Bordit të Grupit të Grave, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Ardian Gjini, Kryetar, Komuna e Gjakovës
- Sibel Halimi, Anëtare e Kryesisë, Lidhja Demokratike e Kosovës

Moderator: Xhemajl Rexha, Kryetar i Bordit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës